

**VENDIM**  
**Nr. 487, datë 10.9.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 23.7.2025, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË  
SHKODËR TË PRONËS, ME EMËRTIMIN ‘GODINA TATIM-TAKSA SHKODËR’,  
ME NUMËR RENDOR 861, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 421,  
DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E LISTËS  
PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË  
PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS’, TË  
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 4, e vendimit nr. 413, datë 23.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronës, me emërtimin ‘Godina Tatim-Taksa Shkodër’, me numër rendor 861, dhe për një shtesë në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës’, të ndryshuar”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**